

## Plani për bashkësi të sigurtë i Komunës së Pejës për vitin 2009

1	<p><b>Titulli:</b> <b>Dhuna në familje – një shqetësim për shoqërinë</b></p> <p><b>Qëllimi:</b> Qëllimi i këtij projekti është të ngrisë vetëdijen e shoqërisë mbi pasojat e dhunës në familje dhe të fuqizuar bashkëpunim në mes të akterëve përkatës për të parandaluar dhunën në familje dhe për të kontribuar në ruajtjen e institucionit të "familjes së shëndoshë".</p> <p><b>Objektivat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Zvogëlimi i rasteve të dhunës në familje;</li><li>✓ Informimi i qytetarëve për fushat më të ndikuara nga dhuna në familje;</li><li>✓ Fuqizimi i Qendrave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje</li></ul>
	<p><b>Titulli:</b> <b>Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore dhe i prostitucionit</b></p> <p><b>Qëllimi:</b> Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të akterëve institucional dhe bashkësisë në aspektin e reintegrimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit dhe ngritja e vetëdijesimit të shoqërisë për rolin e saj në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit.</p> <p><b>Objektivat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Mbështetja përmes programeve psiko-sociale dhe trajnimeve për personat e prekur nga trafikimi me qenie njerëzore dhe prostitucionit</li><li>✓ Zvogëlimi i parakushteve / rrethanave të cilat shpijnë drejt trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit</li><li>✓ Informimi dhe ngritja e vetëdijesimit lidhur me gjendjen aktuale.</li></ul>
3	<p><b>Titulli:</b> <b>Siguria në shkollë</b></p> <p><b>Qëllimi:</b> Shtimi i nivelit të sigurisë, parandalimi i krimit dhe fuqizimi i bashkëpunimit në mes të autoritete të ndryshme në fushën e sigurisë në shkolla.</p> <p><b>Objektivat</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Perceptimi më i mirë i sigurisë</li><li>✓ Shtimi i sigurisë në shkollat e mesme në Prizren</li><li>✓ Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse për siguri</li><li>✓ Aktivizimi i mekanizmave shkollorë në zgjidhjen e problemeve</li><li>✓ Zvogëlimi i krimeve dhe frikës nga krimi</li><li>✓ Unifikimi i politikave të sigurisë në shkolla.</li></ul>
	<p><b>Titulli:</b> <b>Për një rini të shëndoshë dhe pa alkool</b></p> <p><b>Qëllimi:</b> Funksionimi i mekanizmave parandalues dhe ngritja e vetëdijes së rinisë për pasojat e konsumimit të alkoolit.</p> <p><b>Objektivat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>✓ Ngritja e vetëdijes dhe informimi i të rinjve lidhur me pasojat që sjell konsumimi i alkoolit.</li><li>✓ Bashkëpunimi në mes të OJQ-ve, EVSB-ve, KK-ve dhe komunitetit afarist në zbatimin e rregulloreve të aplikueshme për kafiteritë.</li></ul>
4	